

AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
**Est. Royal 1939 SHPK**

Ky Akt Themelimi mbështetet ne ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", për themelimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar **Est. Royal 1939 SHPK**,

**Neni 1**

*Emri*

- 1.1 Shoqëria tregtare mban emrin **Est. Royal 1939** shpk
- 1.2 Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të behet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**Neni 2**

*Forma*

- 2.1 Shoqëria tregtare **Est. Royal 1939** shpk, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**Neni 3**

*Zyra qendrore*


- 3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **Est. Royal 1939** shpk, do të ketë zyrën e saj qendrore në, Lagja 11Janari, Sheshi Çerçiz Topulli nr 5, Pazar, Gjirokastër 6001, Shqipëri.
- 3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**Neni 4**

*Objekti i veprimtarisë*

- 4.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

Të operojë si një strukture akomoduese ne fushën e hoteleri - turizëm bashkë me anekset e tjera si bar, restorant, shërbime transporti për catering për



aktivitete dhe shërbime për konferenca, seminare si dhe aktivitete te tjera të kësaj natyre.

4.2 Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

### **Neni 5** *Kohëzgjatja*

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë **Est. Royal 1939** shpk do të jetë e pacaktuar.

### **Neni 6** *Kapitali i shoqërisë dhe Kuotat*

6.1 Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **Est. Royal 1939** shpk është 10.000 (dhjetëmijë) lek, i gjithi i nënshkruar dhe i shlyer.

6.2 Ortakët kanë kontribuar dhe zotërojnë në kapitalin e shoqërisë kuotat si më poshtë:

- Shoqëria Karaja Consulting shpk, e regjistruar në QKB me NUIS: L81630011U, e cila zotëron 100% të kuotave të kapitalit si një kuotë e vetme;


### **Neni 7** *Asambleja*

7.1 Organi vendimmarrës i shoqërisë është **Asambleja e Përgjithshme**

### **Neni 8** *Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme*

8.1 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- Ndryshimet e statutit;
- Emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
- Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;



- Përcaktimin e shpërblimeve, për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshi përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- anulimin e kuotave;
- largimin ose përjashtimin e ortakut;
- dhënien e miratimit të administratorëve, për të vepruar lidhur me kufizimet e parashikuara në nenin 18 të statutit.

### **Neni 9**

#### *Administratori*

9.1 Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.


Shoqëria administratohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është deri në 5 vjet. Administratori kryen të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë dhe përfaqëson shoqërinë tregtare në marrëdhënie me të tretët për sa i përket realizimit të objektit të shoqërisë.

9.2 Administratori i shoqërisë caktohet Z.Irakli Premti i lindur me Tirane i datelindjes 23.01.1978 me ID H80123121S, për një periudhë kohe nga data 1.2.2023 deri më datë 31.1.2028.

9.3 Administratori i shoqërisë mund të delegojë kryerjen e detyrave të administrimit tek një person i tretë jashtë shoqërisë.

### **Neni 10**

10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



## **Neni 11**

11.1 Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet ligji 9901.

*Ky STATUT hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjithë me të njëjtën vlerë ligjore, njëra nga të cilat qëndron në dokumentacionin bazë të shoqërisë.*

### **ORTAKËT THEMELUES**

**Shoqëria Karaja Consulting shpk**

**Administratori**

Aldor Karaja

